



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.132**

**8 tetor**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

|                                             |                                                                                                                                                                                              | Faqe |
|---------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr.121, datë 24.9.2007 | Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe<br>Televizionit .....                                                                                                          | 3663 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.122, datë 24.9.2007 | Për zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios<br>dhe Televizionit .....                                                                                                      | 3663 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.123, datë 24.9.2007 | Për zgjedhjen e katër anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së                                                                                                                             | 3664 |
| Dekret nr.5473<br>datë 4.10.2007            | Për dhënie të shtetësisë shqiptare .....                                                                                                                                                     | 3664 |
| Vendim i KM<br>nr.624, datë 19.9.2007       | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me<br>koncesion të hidrocentralit “Thanë”, dhe miratimin e bonusit, në<br>procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.. | 3665 |
| Udhëzim i MASH<br>nr.24, datë 3.9.2007      | Për procedurat e njohjes së diplomave dhe certifikatave të fituara<br>në shkollat e larta të huaja .....                                                                                     | 3665 |
| Vendim i GJK<br>nr.34, datë 3.10.2007       | Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.13, datë 9.3.2006 të<br>Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm<br>me Kushtetutën .....                                           |      |
| Kërkesë e MPPTT<br>nr.7402, datë 4.10.2007  | Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme,<br>pronë private, që preken nga rehabilitimi i rrëshqitjes “Guri i<br>Renzit” Librazhd .....                                 | 3669 |

**VENDIM**  
**Nr.121, datë 24.9.2007**

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE  
TELEVIZIONIT**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Mesila Doda zgjidhet në detyrën e Kryetares së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.122, datë 24.9.2007**

**PËR ZGJEDHJEN E TRE ANËTARËVE TË KËSHILLIT  
KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT):

1. Artan Zeneli,

2. Gent Ibrahimimi.

II. Zoti Sami Nezaj zgjidhet anëtar i KKRT-së në vend të zotit Ledi Bianku.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.123, datë 24.9.2007**

**PËR ZGJEDHJEN E KATËR ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të nenit 88 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Zgjidhen në detyrën e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së:

1. Robert Rakiplari,
  2. Fatmir Toçi,
  3. Petrit Ymeri,
  4. Lorenc Vangjeli.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**DEKRET**  
**Nr.5473, datë 4.10.2007**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9, pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:  
Ilir Niko Misha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.624, datë 19.9.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME**  
**KONCESION TË HIDROCENTRALIT “THANË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË**  
**PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1 Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Thanë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2 Miratimin e bonusit prej 6 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Delia Group” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr.24, datë 3.9.2007**

**PËR PROCEDURAT E NJOHJES SË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE TË FITUARA**  
**NË SHKOLLAT E LARTA TË HUAJA**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 37 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Fusha e veprimtarisë së njohjes në MASH:

Fusha e veprimtarisë së njohjes së kualifikimeve të fituara, që kryhet nga Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë është:

a) të administrojë dhe të kryejë procedurat për të gjitha aplikimet për njohje të diplomave të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të diplomave “Master i nivelit të dytë”, si dhe certifikatave të specializimit të fituara jashtë shtetit;

b) të kryejë procedurën verifikuese për vërtetësinë e certifikatave apo diplomave të tjera universitare, të fituara jashtë shtetit që nuk përfshihen në pikën “a”, kur kërkohet nga institucione të tjera;

c) të kryejë procedurën verifikuese për vërtetësinë e certifikatave apo diplomave universitare të fituara në Republikën e Shqipërisë, kur kërkohet nga institucione të tjera jashtë shtetit;

d) të mos shqyrtojë aplikime për rastet si më poshtë:

i) diploma dhe kualifikime të fituara nga institucione të akredituara në Republikën e Shqipërisë;

ii) kurse studimi të paplotësuara ose kurse që nuk përputhen me kornizat e pranuar europiane dhe kombëtare;

iii) kurse me më pak se një semestër;

iv) certifikata për kurse të vetme si gjuhë e huaj, kompjuter etj.;

v) diploma ose certifikata lëshuar nga institucione të huaja, të cilat nuk kanë legjitimitetin e duhur;

vi) dokumentet që nuk janë origjinale apo të njëvlefshme me to;

vii) diploma ose certifikata të fituara në shkolla të larta ushtarake, përjashtuar ato diploma për specialitete civile;

viii) diploma dhe certifikata të fituara në shkolla të larta fetare, përjashtuar diplomat për specialitete civile.

## 2. Aplikimi

### 2.1 Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- a) formatin e aplikimit të plotësuar;
- b) diplomën ose certifikatën/vërtetimin e diplomimit;
- c) listën e notave;
- d) dokument zyrtar identiteti, certifikatë lindjeje origjinale me fotografi dhe fotokopje e pasaportës, ndërsa për shtetasit e huaj: fotokopje e pasaportës dhe kartës së identitetit;
- e) mandatpagesën.

2.2 Aplikimi nuk pranohet, nëse mungon një nga dokumentet e mësipërme. Dokumentet pranojnë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentet e përcaktuara në pikat “b” dhe “c”, si dhe në pikën “d” për shtetasit e huaj, duhet të jenë me përkthim të vërtetuar.

Të paktën një nga dokumentet bazë që konfirmon diplomimin apo mbarimin e suksesshëm të kursit të studimit që do njihet, duhet të jetë i legalizuar me vulën Apostille ose nga ambasada shqiptare/Ministria jonë e Punëve të Jashtme. Në rast pamundësie të marrjes së legalizimit, aplikimi do të pranohet edhe pa dokument të legalizuar dhe do të procedohet sipas përcaktimeve specifike në këtë udhëzim.

2.3 Sektori i Njohjes së Diplomave dhe i Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SENJOD) mund të kërkojë edhe dokumente të tjera, që janë të nevojshme për procedurën e njohjes për raste të caktuara. Këto dokumente përfshijnë suplementin e diplomës, kur lëshohet nga një institucion i huaj dhe programin zyrtar të kursit të studimit, në mbështetje të argumenteve të nevojshme në procedurën e njohjes.

2.4 Aplikanti dorëzon dosjen në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun, e cila pranon dosjen vetëm nëse ajo është plotësuar konform kërkesave të pikave 2.1 dhe 2.2. SENJOD-i vë në dispozicion të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të gjithë informacionin e nevojshëm orientues për aplikantët. Pas pranimit të aplikimit, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun i lëshon aplikantit një konfirmim, si dhe vërtetim për aplikimin, me përjashtim të rasteve ose gruprasteve kur Komisioni i njohjes vendos lëshimin e vërtetimit pas realizimit të kushteve paraprake.

2.5 Aplikimi mund të dërgohet edhe me postë.

2.6 Aplikimi për njohjen e diplomave të ndryshme të të njëjtit aplikant, të lëshuara nga i njëjti institucion, konsiderohet si një aplikim dhe paguhet një tarifë.

### 3. Verifikimi i vërtetësisë së dokumenteve

3.1 SENJOD-i kryen verifikimin për të gjitha rastet, përfshi edhe njohjen e drejtpërdrejtë, për autenticitetin e diplomës apo certifikatës së huaj, si dhe për statusin dhe legjitimitetin e institucionit që e ka lëshuar. Për vërtetësinë e diplomimit ose plotësimit të programit të studimit të pretenduar, SENJOD-i bazohet në dokumentin zyrtar që e konfirmon këtë, të legalizuar sipas paragrafit 2.2.

3.2 Në të gjitha rastet kur dokumenti bazë, nuk është i legalizuar sipas përcaktimeve të paragrafit 2.2, SENJOD-i nuk bazohet në dokumentin e paraqitur, por kryen verifikimin e tij:

- a) në faqen e internetit të institucionit ku janë kryer studimet; ose
- b) nëpërmjet kanaleve diplomatike; ose
- c) nëpërmjet zyrës analoge për njohjen e diplomave në shtetin ku është kryer kursi i studimeve; ose
- d) me postë, faks ose e-mail me institucionin e arsimit të lartë ku është kryer kursi i studimeve.

3.3 SENJOD-i kryen edhe verifikim dytësor, i cili është i ndryshëm nga baza e parë e verifikimit, dhe kryhet nëpërmjet njërës prej mënyrave të përcaktuara në paragrafin 3.2.

3.4 Materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit.

3.5 Në rastet kur verifikimi dytësor nuk është realizuar brenda afateve të përcaktuara për shkaqe objektive, aplikimi merret në shqyrtim nga Komisioni i Njohjes në MASH. Për këto raste, Komisioni shqyrton vlerën e provës ekzistuese, pamundësinë objektive për të kryer verifikimin dytësor, si dhe mundësinë e intervistës profesionale me aplikantin. Në përfundim, Komisioni vendos për njohjen e diplomës apo certifikatës së huaj, ose për procedimin e mëtejshëm deri në realizimin e verifikimit dytësor.

3.6 Me propozim të Komisionit të Njohjes, zëvendësministri për arsimin e lartë pezullon procedurën e njohjes për raste ose gruprastesh të veçanta, kur ka informacione dhe konstatime që

hedhin dyshime mbi vërtetësinë e dokumenteve shkollore ose kryerjen e programit të studimit të pretenduar, dhe përcakton afatet dhe masat për shqyrtimin e mëtejshëm të procedurës.

#### 4. Vendimi i njohjes

4.1 Vlerësimi i nivelit, profilit dhe drejtimit që përfshin një diplomë apo certifikatë e caktuar, kryhet nga Komisioni i Njohjes së MASH-it për rastet:

- a) që janë pjesë e kuadrit të një marrëveshjeje ndërshtetërore;
- b) kur një diplomë është lëshuar nga një institucion i akredituar në një nga vendet e listuara në aneksin bashkëngjitur këtij udhëzimi; dhe
- c) kur për të njëjtin program studimi/titull diplome lëshuar në të njëjtin shtet, një komision i mëparshëm i MASH-it, ka marrë një vendim njohjeje.

4.2 Komisioni i Njohjes mund të vendosë të mos marrë vendim për një nga rastet e mësipërme dhe ia përcjell aplikimin dhe rekomandimin e vet në funksion të vendimit përfundimtar lidhur me vlerësimin në kuadër të njohjes, fakultetit përkatës në një nga institucionet e arsimit të lartë në vend, sipas përcaktimit në paragrafin 4.3. Komisioni i Njohjes mund të marrë vendim përfundimtar lidhur me vlerësimin e diplomës/certifikatës dhe kursit të studimit për njohje të pjesshme edhe për raste që nuk përfshihen në paragrafin 4.1, në rastet kur janë të dukshme diferencat substanciale në program kundrejt programeve dhe standardeve kombëtare dhe kuadrit kombëtar të kualifikimeve.

4.3 Për rastet që ngelen jashtë përcaktimeve të paragrafit 4.1, marrë në konsideratë edhe përcaktimin në paragrafin 4.2, Komisioni i Njohjes shqyrton vetëm autenticitetin e kursit të studimit të kryer dhe të legjitimitetit të institucionit lëshues, konform kapitullit 3 të këtij udhëzimi, dhe jep rekomandimin e vet për fakultetin që do të kryejë vlerësimin përfundimtar lidhur me njohje të pjesshme apo të plotë, bazuar në standardet e njohura kombëtare dhe ndërkombëtare të njohjes dhe në praktikat e njohjes.

4.4 Dosja e aplikantit i paraqitet Komisionit të Njohjes së MASH-it jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi dhe plotësimi i dosjes prej specialistit të SENJOD-it. Në përfundim, Komisioni i Njohjes, brenda një jave nga marrja e dosjes, mund të marrë vendim sipas përcaktimit në paragrafin 4.1 ose përcaktimit në paragrafin 4.3, ose mund të vendosë t'ia kthejë dosjen SENJOD-it për plotësime të nevojshme, bazuar në këtë udhëzim. Në përfundim të procedurës, aplikantit i lëshohet një certifikatë njohjeje nga MASH-i jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës, firmosur nga kryetari i Komisionit të Njohjes. Në certifikatë përfshihen edhe vitet e studimit, profili i diplomës së bashku me drejtime sekondare që nënkupton një program studimi, kur nuk përfshihet ose nuk është i ngjashëm me formatet zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Për rastet që përfshin përcaktimi në paragrafin 4.3, dosja e aplikantit, së bashku me një kopje të certifikatës së njohjes që përmban edhe rekomandimin përfundimtar për vlerësimin në kuadrin e njohjes, i përcillet fakultetit përkatës të IAL.

4.5 Dekani i fakultetit përkatës të IAL-së ngre Komisionin e Njohjes dhe kryen njohjen në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në statut dhe në rregulloret e institucionit të arsimit të lartë. Kur vendimi nga fakulteti përkatës i IAL-së nuk përputhet me rekomandimin e lëshuar në certifikatën e njohjes nga MASH-i, fakulteti përkatës i IAL duhet të konsultohet paraprakisht me Komisionin e Njohjes së MASH-it para marrjes së vendimit.

4.6 Në kuadrin e njohjes dhe vlerësimit merren në konsideratë të drejta akademike jo më pak nga ato që njihen në vendin e origjinës, por asnjëherë jo më shumë se ato që njihen në vendin tonë. Bazë e vlerësimit të programit dhe kursit të kryer janë lëndët e programit, ngarkesa mësimore (në kredite), vitet e studimit, plotësimi i kuadrit bazë, rezultatet e të mësuarit dhe formimit të marrë, të drejtat akademike dhe profesionale që specifikohen apo nënkuptohen nga kuadri kombëtar i vendit të origjinës, krahasuar kundrejt kuadrit tonë kombëtar. Në rastet e njohjes së pjesshme, duhet argumentuar, bazuar në përcaktimet e mësipërme, se ka diferenca substanciale të konsiderueshme. Komisioni i Njohjes i MASH-it mund t'i kërkojë aplikantit edhe intervistë.

4.7 Në rastet e mosnjohjes së kursit të studimeve dhe kualifikimit të marrë, kryetari i Komisionit njofton me shkrim aplikantin për mosnjohjen dhe arsyet brenda 10 ditëve nga përfundimi i procedurës.

4.8 Në rast informacionesh zyrtare që provojnë pavërtetësinë e informacioneve të mëparshme, mbi bazë të të cilave është marrë një vendim për njohje diplome apo kualifikimi, Komisioni i Njohjes rishikon vendimin e marrë.

4.9 SENJOD-i përfundon procedurën e njohjes brenda 90 ditëve.

4.10 Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankimim. Kur ankimimi ka objekt vendimin e fakultetit,

ankimimi kryhet te Komisioni i Njohjes. Në rastet kur objekt i ankimit është vendimi i Komisionit të Njohjes në MASH, ankimimi kryhet te Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ankuesit i kthehet përgjigje brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

4.11 Aplikanti mund të bëjë ankesë edhe në rast vonese të paarsyetuar. Në rastet kur vonesa ka ardhur jashtë përcaktimeve në këtë udhëzim dhe si rezultat i mosveprimit të autoritetit shqyrtues, merren masat konform Kodit të Procedurave Administrative.

4.12 SENJOD-i nuk mban përgjegjësi administrative konform Kodit të Procedurave Administrative, për vonesa që vijnë për shkak të mospërgjigjes në kohë të aplikantit për dorëzimin e dokumenteve shtesë, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim, apo vonesa të përgjigjes prej organit, të cilit i është kërkuar informacion.

5. Dispozita kalimtare

5.1 Rastet e njohjes me komisionet *Ad-Hoc*, sipas udhëzimit nr.45, datë 8.12.2006, për të cilat është plotësuar shqyrtimi deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të përfundohen mbi bazën e këtyre komisioneve *Ad-Hoc*.

5.2 Tarifa do të vazhdojë të jetë 10.000 lekë, deri në një përcaktim të ri me një akt të posaçëm, konform kuadrit ligjor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

Diplomat e lëshuara nga institucione të arsimit të lartë akredituar në shtetet e mëposhtme, do të procedohen sipas përcaktimit në paragrafët 4.1 dhe 4.2.

1. Shtetet e BE-së, për diploma të lëshuara në kohën kur ky shtet ka qenë anëtar i BE-së;
2. Zvicër;
3. Norvegji;
4. SHBA;
5. Kanada;
6. Japoni;
7. Kore e Jugut.

**VENDIM**  
**Nr.34, datë 3.10.2007**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                   |                                 |
|-------------------|---------------------------------|
| Vladimir Kristo   | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, |
| Gjergj Sauli      | Anëtar i “ “                    |
| Fehmi Abdiu       | Anëtar i “ “                    |
| Kujtim Puto       | Anëtar i “ “                    |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i “ “                    |
| Petrit Plloçi     | Anëtar i “ “                    |
| Sokol Sadushi     | Anëtar i “ “                    |
| Sokol Berberi     | Anëtar i “ “                    |
| Kristofor Peçi    | Anëtar i “ “                    |

me sekretare Brunilda Bara, në datë 19.6.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.39 Akti, që i përket:

KËRKUES: 1.VEHAP LAMAJ, përfaqësuar nga avokat Genc Gjokutaj, me prokurë.

2. ZHULJETA LAMAJ, përfaqësuar nga avokat Artan Zeneli, me prokurë.
3. ANASTASIOS PETROUPOLOS, përfaqësuar nga avokat Paskal Haxhi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. MINISTRIA E BRENDSHME, përfaqësuar nga Enton Drogu, me autorizim.
2. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, përfaqësuar nga Shamet Shabani e Ervina Domi, me autorizim.
3. SHOQËRITË “M.LEKA” NË ADMINISTRIM, “VEFA” NË ADMINISTRIM, “GJALLICA” NË ADMINISTRIM, “KAMBERI” NË ADMINISTRIM, “CENAJ” NË ADMINISTRIM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.13, datë 9.3.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f e 134/g të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 44 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

1. Njërit prej kërkuesve, që ka qenë person i tretë në gjykim, nuk i është komunikuar rekursi i ushtruar nga pala tjetër dhe për pasojë, është privuar nga pjesëmarrja në gjykim në gjykatë;
2. Subjektet që kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nuk legjitimohen për ta bërë atë, prandaj Gjykata e Lartë, në shqyrtimin e çështjes, është vënë në lëvizje nga subjekte të palegjitimuara;
3. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë zhvilluar proces të parregullt, pasi kanë kryer një sërë shkeljesh që cenojnë standardet kushtetuese. Vendimi bazohet kryesisht në provat e parashtruara dhe të argumentuara nga pala e paditur, kur Gjykata e kishte për detyrë të analizonte në mënyrë të gjithanshme provat dhe faktet e paraqitura nga të dyja palët.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçin, përfaqësuesit e kërkuesve, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me padinë objekt gjykimi, paditësit Vajdin Lamaj dhe Anastasios Petropoulos kanë kërkuar të njihen pronarë të vetëm të objektit “Bar restorant Drini”, duke u konstatuar pavlefshmëria absolute e kontratës së shitblerjes datë 14.12.1999, të lidhur ndërmjet të paditurve.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3127, datë 12.7.2002, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.662, datë 23.5.2003 ka vendosur: “-Ndryshimin e vendimit nr.3127, datë 12.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; - Pranimin e kërkesëpadisë së ngritur nga paditësit V.Lamaj dhe A.Petropoulos; - Konstatimin e pavlefshëm të kontratës së shitjes me nr.1987 Rep., dhe nr.353 Kol., datë 14.12.1999, të lidhur midis administratorëve të shoqërive “M.Leka”, “Gjallica”, “Vefa”, “Silva”, “Cenaj”, “Kamberi” si shitës; dhe Ministria e Pushtetit Lokal, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si blerës; për objektin “Bar restorant Drini”; - Fshirjen nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme të pronës për objektin “Kafe bar Drini” për Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; - Urdhërimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të regjistrojë objektin restorant “Kafe bar Drini” në emër të paditësve Vajdin Lamaj dhe Anastasios Petropoulos”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.13, datë 9.3.2006, kanë vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se nga tërësia e pretendimeve dhe shkaqeve të ngritura në kërkesë, kontrolli kushtetues duhet të përqendrohet në shkeljet që cenojnë standardet e procesit të rregullt ligjor. Kërkuesi Vehap Lamaj, që në fillim të procesit në shkallë të parë, mbi kërkesën e paditësve, i është bashkuar çështjes si person i tretë dhe si i tillë është trajtuar dhe ka marrë pjesë në të dyja shkallët e gjykimit, duke pasur të gjitha të drejtat e palëve në gjykim, sipas nenit 195 të Kodit të Procedurës Civile. Me vendimin e Gjykatës së Apelit, të dhënë në favor të tij, u krijua një stabilitet në

zgjidhjen e konfliktit dhe njëkohësisht një garanci juridike, e cila mund të cenohet vetëm në kushtet e parashikuara në ligj. Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuessit Vehap Lamaj nuk i është komunikuar kopja e rekursit të ushtruar nga pala tjetër ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Rekursi që ushtrohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit, i duhet njoftuar palës së interesuar, për t'i dhënë asaj mundësi për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe për t'u mbrojtuar.

Në rastin në shqyrtim, moskomunikimi i rekursit i ka mohuar kërkuessit të drejtën e pjesëmarrjes në gjykim në gjykatë dhe të mbrojtjes, gjë që e bëri procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Privimi i palës në proces nga mundësia, që nëpërmjet përfaqësimit të mbrojtë interesat e veta në gjykim, është konsideruar shkelje e standardeve të procesit të rregullt në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese.<sup>1</sup>

E drejta për t'u mbrojtur, e cila realizohet nëpërmjet të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim, përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor. Realizimi i kësaj të drejte shtrun para organeve gjyqësore detyrimin për të njoftuar palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, për të siguruar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar padrejtësisht nga gjykimi.

Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimeve të saj, ka vënë në dukje se pjesëmarrja e palëve në gjykim, dëgjimi i pretendimeve të tyre për provat dhe interpretimin e ligjit në çështjen konkrete garantohej nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se kjo pjesëmarrje, i shërben palëve për të bërë një mbrojtje sa më efektive, por njëkohësisht është dhe në interes të drejtësisë.

Lidhur me pretendimin e kërkuessit për moslegjitimit të subjekteve për të ushtruar rekurs, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në rastin konkret, Avokati i Shtetit legjitimohet të ushtrojë rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit. Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron në gjyq interesat pasurore të shtetit për investimet e tij në subjektet publike ose private. Sipas nenit 1, pika 3 të ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", "Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin dhe mbrojtjen në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit", prandaj vënia në lëvizje e Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes nuk është bërë nga subjekte të palegjitimuara.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuessit është e drejtë. Kjo për arsye se gjykimi i çështjes pa iu njoftuar rekursi palës së interesuar dhe pa siguruar pjesëmarrjen e saj në gjykim, ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.13, datë 9.3.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: F.Abdiu, Gj.Sauli, K.Peçi, S.Berberi, S.Sadushi.

Anëtarë kundër: V.Kristo (kryetar), P.Plloçi, Xh.Zaganjori, K.Puto.

#### SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për

---

<sup>1</sup> Vendimet nr.6, datë 16.2.2007; nr.13, datë 13.4.2007; nr.8, datë 2.6.2006; nr.16, datë 8.6.2006; nr.11, datë 18.5.2005; etj. të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i rrëshqitjes “Guri i Renzit” Librazhd.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen e titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronari për të cilin në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, do të kompensohet për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të ketë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 510 000 (pesëqind e dhjetë mijë) lekë.

| Nr.    | Emri                | Nr.pasurisë | Sipërfaqe<br>m <sup>2</sup> | Çmimi<br>lekë/m <sup>2</sup> | Vlera lekë    | Shënime                 |
|--------|---------------------|-------------|-----------------------------|------------------------------|---------------|-------------------------|
| 1.     | Shefki Mehmet Dosku | 596         | 850                         | 600                          | 510000        | Plotësim dokumentacioni |
| Totali |                     |             |                             |                              | <b>510000</b> |                         |

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

## **BOTIME TË REJA** *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

### ***Së shpejti në treg:***

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 8.10.2007  
Doli nga shtypi më 8.10.2007

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 61x86/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja "Nënë Tereza"  
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë